



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 18.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.11.2022, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. EURO CONSTRUCTION ; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : **“Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave “ , Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521, nxjerr:**

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. EURO CONSTRUCTION ; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.**, e dt.15.11.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave “ , Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521.**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK – së, të datës 10.11.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 10.11.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

Ar sy e t i m

Me dt.15.11.2022, **Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. EURO CONSTRUCTION ; IDEOR CONSTRUCTION SH.P.K.**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **“Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave “ , Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 18.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje që nuk ju ka kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së, është i pa bazuar.

Autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me nenet 59 dhe 69 të LPP-së, sepse ju si Grup i Operatoreve Ekonomik keni prezantuar listën e stafit profesional dhe punëtoreve prej 12 vetave ,e cila nuk i plotëson kërkesat e FDT-së, prandaj në këtë rast sipas nenit 59 të LPP-së nuk mund të kërkohej sqarime shtesë sepse kjo do të thoshte ndërrim material, kurse sipas nenit 69 të LPP-së nëse është dorëzuar një listë e cila nuk përmbush kërkesat minimale të kërkuara,tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Pretendimi juaj lidhur me vërtetimin e ATK-së së operatorit ekonomik të propozuar për kontratë , nuk qëndron, sepse i njëjti na ka prezantuar Vërtetimin e ATK-së, ku ceket se është në marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxheve dhe kjo ka qenë e mjaftueshme për Autoriteti kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës